



Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që
përfundon më 31 Dhjetor 2020**

PËRMBAJTJA**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	7
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	8
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	9
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	10
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	11 – 48

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Menaxhmentin e Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon në këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin '*Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Theksim i çështjeve

Pa kualifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendje si në vijim:

- i. Siç është shpalosur në shënimin 13 të pasqyrave financiare shoqëruese, aktivitetet e Kompanisë krijojnë nevojën e kostove të rëndësishme në të ardhmen në lidhje me dëmtimin e mjedisit dhe dekomisionimit të pasurive të saj afatgjata. Më 31 dhjetor 2020, bilanci i provizionit në lidhje me këto kosto mjedisore arrin 28,731 mijë euro (2019: 30,001 mijë euro). Për më tepër, Kompania ka shpalosur në shënimin 25.F, kostot e vlerësuar të dekomisionimit të cilat nuk njihen si detyrime në pasqyrat financiare të Kompanisë pasi që nuk është përgjegjëse nga legjislacioni aktual të bëjë dekomisionimin e pasurive të saj. Shuma përfundimtare e këtyre provizioneve varet nga vlerësimet periodike të ndikimeve në mjedis dhe ndryshimet e ardhshme të legjislacionit në lidhje me detyrimet e dekomisionimit. Shumat aktuale mund të ndryshojnë materialisht nga këto vlerësime.
- ii. Siç është shpalosur në shënimin 4 të pasqyrave financiare shoqëruese, të përfshira në pronat dhe ndërtesat janë pasuri të caktuara, të cilat janë nën kontrollin e Kompanisë, por për të cilat Kompania nuk posedon dokumentacionin përkatës të pronësisë. Kompania është në proces të marrjes së dokumentacionit të pronësisë, por kohëzgjatja dhe rezultati i procesit nuk mund të përcaktohet me ndonjë saktësi të arsyeshme, në këtë fazë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykit të tonë profesional, ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi të, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje. Secila çështje kryesore dhe adresimi ynë respektiv është përshkruar më poshtë.

Çështje kryesore e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p>Përcaktimi i normës së zhvlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve</p> <p>Prona, impiantet dhe pajisjet më 31 dhjetor 2020 arrin një vlerë neto në libra prej 296,365 mijë euro e cila përbën 70% të gjithsej pasurive. Zhvlerësimi i akumuluar arriti në 513,062 mijë euro.</p> <p>Ne kemi identifikuar përcaktimin e jetëgjatësisë së pronës, impianteve dhe pajisjeve si çështje kryesore të auditimit, sepse kërkohet nga menaxhmenti të ushtroj gjykim të rëndësishëm në lidhje me përcaktimin e jetëgjatësisë së pasurive duke konsideruar natyrën, kohën dhe gjasat e ndryshimit të faktorëve teknik të cilët mund të ndikojnë në jetëgjatësinë e dobishme të pasurive dhe prandaj mund të ketë një ndikim material në shpenzimet e zhvlerësimit për vitin.</p> <p>Ne i referohemi shënimeve të pasqyrave financiare 2.6 dhe 4 Prona, impiantet dhe pajisjet.</p>	<p>Auditimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve ishte një kombinim i auditimit të kontrolleve dhe procedurave thelbësore të auditimit. Përgjigjja jonë e auditimit është si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ne kemi marrë një kuptueshmëri mbi gjykimin e menaxhmentit në lidhje me vlerësimet për përcaktimin e normës së zhvlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe kemi testuar kontrollet kryesore. - Mbi bazën e një mostre, ne kemi zgjedhur dhe krahasuar jetën e dobishme të pasurisë në vitin aktual me vitin paraprak për të përcaktuar nëse ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në jetën e dobishme të pasurive, dhe kemi konsideruar arsyeshmërinë e ndryshimeve bazuar në njohuritë tona për biznesin dhe industrinë. - Sa i përket shtesave të pasurive, ne kemi testuar nëse shtesat (blerjet) janë klasifikuar në kategorinë e duhur, fillimi i zhvlerësimit në kohën e duhur dhe jeta ekonomike e përcaktuar ishte në përputhje me jetën ekonomike të përdorur nga kompania dhe të paraqitura në politikat e kontabilitetit. - Ne kemi sfiduar supozimet dhe gjykimet kritike të përdorura nga menaxhmenti duke krahasuar vlerësimet dhe planet e kaluara të menaxhmentit me vlerësimet dhe planet e vitit aktual dhe duke marrë parasysh zhvillimin në sektorin e energjisë në vend. - Ne kemi vlerësuar përshtatshmërinë e shpalosjeve të Kompanisë në lidhje me pronën, impiantet dhe pajisjet.

Çështje kryesore e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p>Provizionet për kontestet gjyqësore dhe detyrimet kontingjente</p> <p>Kompania është e përfshirë në një numër të madh të procedurave ligjore. Rezultati i këtyre procedurave dhe çështjeve gjyqësore varet nga ngjarjet e ardhshme.</p> <p>Gjykimi i menaxhmentit është i përfshirë në vlerësimin e kontesteve gjyqësore (pasive) dhe në konsiderimin e mundësisë që një padi të jetë e suksesshme dhe ne e përcaktuam atë si fushë të fokusit të auditimit. Rreziku që lidhet me kontestet gjyqësore shoqërohet kryesisht me plotësinë e shpalosjeve dhe plotësinë e provizioneve në pasqyrat financiare.</p> <p>Ne i referohemi shënimit 13 në pasqyrat financiare Provizionet për kontestet gjyqësore dhe shënimit 25 B Detyrimet Kontingjente.</p>	<p>Si pjesë e procedurave tona të auditimit, ne kemi vlerësuar proceset e menaxhmentit për të identifikuar detyrimet e reja të mundshme dhe ndryshimet në detyrimet ekzistuese për respektimin e politikave të Kompanisë dhe kërkesave të SNK 37.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbi bazën e mostrës ne kemi analizuar ndryshimet nga periudhat e mëparshme dhe kemi marrë një kuptim të hollësishëm të këtyre zërave dhe supozimeve të aplikuara. - Si pjesë e procedurave tona të auditimit, ne kemi shqyrtuar procesverbalet e mbledhjeve të bordit, përfshirë nën-komitetet. - Ne kemi marrë nga departamenti ligjor listën e rasteve gjyqësore të pazgjidhura dhe e kemi rakorduar regjistrimet e kontabilitetit. - Ne kemi biseduar me menaxhmentin në lidhje me përshtatshmërinë e provizioneve. - Ne kemi kryer procedura shtesë të testimit në një mostër për çështjet gjyqësore të regjistruara në fund të vitit duke shqyrtuar pagesat pas përfundimit të vitit dhe duke vlerësuar përshtatshmërinë e tyre. - Ne kemi vlerësuar përshtatshmërinë e shpalosjes në lidhje me provizionet dhe detyrimet kontingjente.

Çështje kryesore e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
Vlera bartëse e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera Dëmtimi nga lejimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta përcaktohen bazuar në vlerësimin e menaxhmentit për njohjen e humbjeve të pritshme të llogarive të arkëtueshme, duke konsideruar vjetërsimin e balancave, ekzistimin e mosmarrëveshjeve, mostrën e pagesave historike të fundit, dhe çdo informacion tjetër të disponueshëm në lidhje me besueshmërinë kreditore të palëve. Prandaj, është përcaktuar si një çështje kryesore e auditimit. Ne i referohemi shënimit 7 në pasqyrat financiare Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera dhe shënimit 27 B.	Procedurat tona të auditimit përfshinë si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> - Ne vlerësuar procedurat e kontrollit kreditor të Kompanisë dhe vlerësuar dhe vërtetuar vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera. - Ne e vlerësuar rikuperueshmërinë në bazë të një mostre duke iu referuar arkëtimeve të pranura pas fundit të vitit, marrëveshjes më kushtet e kontratës në fuqi, dhe lëshimi i notave të kreditit pas fundvitit, sipas nevojës; - Ne kemi marrë në bazë të mostrës konfirmimet nga palët e treta, dhe kemi rakorduar diferencat. - Ne kemi konsideruar përshtatshmërinë e gjykimeve në lidhje me lejimet e dëmtimit për të arkëtueshme tregtare dhe kemi vlerësuar mjaftueshmërinë e tyre. - Ne kemi konsideruar plotësinë dhe saktësinë e shpalosjeve.

Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përfshin raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informatat tjera dhe përveç se në masën e shprehur në mënyrë eksplicite në raportin tonë, ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar.

Në lidhje me raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative ne kemi marrë parasysh nëse ai përfshin shpalosjet e kërkuara nga neni 7 i Ligjit nr. 06 / L – 032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditim.

Bazuar, vetëm në punën që kërkohet të bëhet gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe procedurave të mësipërme, sipas opinionit tonë:

- informacioni i shpalosur në raportin e menaxhmentit për vitin financiar për të cilin janë përgatitur pasqyrat financiare, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale me informacionin në pasqyrat financiare dhe përgatitet në përputhje me kërkesat e nenit 7 të Ligjit nr. 06/ L–032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, dhe,
- deklarata e qeverisjes korporative është përgaditur në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 06/L–032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe është konsistent me informacionin në pasqyrat financiare.

Për më tepër, bazuar në njohuritë dhe kuptimin e entitetit dhe mjedisit në të cilin operon, të marra gjatë auditimit, neve na kërkohet të raportojmë nëse kemi identifikuar ndonjë keqdeklarim material të fakteve në informata të tjera. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuadojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu iu deklarojmë personave të ngarkuar me qeverisjen se ne jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike përkatëse lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera arsyeshëm mund të mendohet se cenojnë pavarësinë tonë, dhe aty ku është e aplikueshme, marrim masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuara personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin kryesore në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale prandaj janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit.

Raport për kërkesat e tjera ligjore dhe kërkesat rregullatore

Ne u zgjodhëm nga një proces i tenderimit të hapur dhe u emëruam më 6 dhjetor 2019 si auditorë të Kompanisë për një periudhë tre vjeçare. Ky është viti ynë i dytë si auditorë të Kompanisë.

Ne konfirmojmë se:

- Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-auditimi të specifikuara në nenin 5 (1) të udhëzimit administrativ nr. 02/2019 dhe kemi qenë të pavarur nga Kompania në kryerjen e auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

31 maj 2021

Astrit Kelmendi


Astrit Kelmendi

Auditor Ligjor

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2020

	Shënimet	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR '000)	Më 31 Dhjetor 2019 (në EUR '000)
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, impiantet dhe paisjet	4	296,365	305,555
Pasuritë e paprekshme	5	221	44
		296,586	305,599
Pasuritë afatshkurtra			
Inventarët	6	19,841	20,725
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, neto	7	40,850	22,614
Tatimi mbi të ardhura i parapaguar		-	899
Paraja në dorë dhe në bankë	8	67,928	67,207
		128,619	111,445
GJITHSEJ PASURITË		425,205	417,044
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti i aksionarëve			
Kapitali aksionar	9	25	25
Rezervat	10	568,784	568,538
Humbjet e akumuluar		(391,403)	(415,187)
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		177,406	153,376
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huazimet - pjesa afatgjatë	11	138,154	149,541
Grantet e shtyera	12	16,156	21,373
Provizionet	13	48,561	48,502
Detyrimet e tatimit të shtyrë	24	10,820	10,171
		213,691	229,587
Detyrimet afatshkurtra			
Huazimet - pjesa afatshkurtër	11	12,051	12,009
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	14	13,799	15,259
Tatimi mbi të ardhura i pagueshëm		613	-
Shpenzimet akruale	15	7,645	6,813
		34,108	34,081
Gjithsej detyrimet		247,799	263,668
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		425,205	417,044

Këto pasqyra financiare janë të autorizuara për lëshim nga Bordi i Drejtorëve dhe të nënshkuara në emër të tyre më 31 Maj 2021:


Z. Përparim Kabashi
 Ushtrues i detyrës së Drejtorit Menaxhues


Z. Gazmend Amaxhekaj
 Drejtor Financiar

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

	Shënimet	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2020	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2019
		(në EUR '000)	(në EUR '000)
Shitjet	16	185,844	176,862
Të hyrat nga grantet	17	5,217	5,847
Të hyrat tjera	18	1,960	2,426
		193,021	185,135
SHPENZIMET OPERATIVE			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(45,662)	(41,816)
Shpenzimet e personelit	19	(54,169)	(56,332)
Energjia elektrike dhe komunalitë	20	(16,630)	(17,923)
Kostot e mirëmbajtjes		(4,753)	(4,016)
Materialet dhe furnizimet		(7,780)	(3,557)
Shpenzimet e linjtit	15	(25,623)	(24,200)
Provizionimet për shlyerjen e inventarit	6	567	1,210
Humbjet nga zhvlerësimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera	27.B	1,012	(2,945)
Ndryshimi në provizione	13	1,898	2,474
Shpenzimet e tjera operative	21	(11,410)	(13,151)
		(162,550)	(160,256)
Fitimi nga operacionet		30,471	24,879
Shpenzimet financiare, neto	22	(1,980)	(2,584)
Fitimi para tatimit		28,491	22,295
Shpenzimet e tatimit në fitim	23	(4,707)	(3,073)
Fitimi neto për vitin		23,784	19,222
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim dhe humbje			
Efekti i tatimit të shtyer në rivlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve	24	246	(493)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		24,030	18,729

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

	Kapitali aksionar (në EUR '000)	Rezervat (në EUR '000)	(Humbjet) e akumuluar (në EUR '000)	Gjithsej (në EUR '000)
Gjendja më 01 Janar 2020				
Transaksionet me pronarët	25	568,538	(415,187)	153,376
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	23,784	23,784
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	246	-	246
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	246	23,784	24,030
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	25	568,784	(391,403)	177,406
Gjendja më 01 Janar 2019	25	569,031	(434,409)	134,647
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	19,222	19,222
Humbjet tjera gjithëpërfshirëse	-	(493)	-	(493)
Gjithsej të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	(493)	19,222	18,729
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	25	568,538	(415,187)	153,376

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

		2020	2019
	Shënimet	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi neto para tatimit		28,491	22,295
Rregullimet për zërat jomonetar			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	45,662	41,816
Amortizimi i granteve	17	(5,217)	(5,847)
Të hyrat nga interesi	22	(1,026)	(77)
Shpenzimet e interesit	22	3,006	2,661
Provizionimi i borxheve të këqija	27.B	(1,012)	2,945
Provizionimi për kostot e mjedisit dhe pensione	13	(1,898)	(2,474)
Provizionimi për shlyerjet/kthimet e inventarëve	6	(567)	(1,210)
Shlyerja direkte e pasurive të tjera		785	-
Shlyerja e pronës, impianteve dhe paisjeve	4,5	261	17
Fitimi para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		68,485	60,126
Inventarët		1,451	(319)
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(16,341)	404
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		1,329	(5,049)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		54,924	55,162
Interesi i arkëtuar		143	77
Interesi i paguar		(2,964)	(2,668)
Tatimi mbi të ardhura i paguar		(3,085)	(2,750)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet operative		49,018	49,821
Paraja nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	4,5	(36,910)	(34,453)
Paraja (e përdorur) në aktivitetet investive		(36,910)	(34,453)
Paraja nga aktivitetet financiare			
Pagesa e huazimeve	11	(11,387)	(10,876)
Paraja (e përdorur) në aktivitetet financiare		(11,387)	(10,876)
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentët e parasë		721	4,492
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		67,207	62,715
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	8	67,928	67,207

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 30 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A. ("Kompania" ose "KEK") është shoqëri aksionare inkorporuar në Kosovë dhe e regjistruar nën Agjencinë e Regjistrimit të biznesit në Kosovë nën numrin e regjistrimit 7032599 me datë 27 dhjetor 2005. Kompania u transformua në një ndërmarrje aksionare (Sh.A.) nën Misionin e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara ("UNMIK") rregullorja nr. 2001/6. Adresa e selisë qendrore së saj të regjistruar është: Rruga Nënë Tereza Nr. 36, 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Kapital fillestar i regjistruar i Kompanisë arrin në 25 mijë euro. Librat e Kompanisë janë hapur që nga 1 janari 2005 bazuar në Raportin e Diligjencës Financiare sipas dates 01 janar 2005 nga një vlerësues i pavarur.

Kompania është 100% në pronësi të Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të Kompanisë janë gjenerimi dhe aktivitetet minerare si nxerrja e linjtit duke përdorur termocentralet e tij.

Struktura aktuale operative e Kompanisë përbëhet nga zyra qendrore e korporatës dhe divizionet e mëposhtëm:

- Divizioni i prodhimit të Linjtit;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova B;
- Divizioni i prodhimit të energjisë - Kosova A;

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova A për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2016 deri më 4 tetor 2020 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_A) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Kjo licencë u zgjat deri më 4 tetor 2021. Për shkak të paaftësisë së Kompanisë për të marrë Lejen e Integruar Mjedisore nga MMPH licenca për Kosovën A rinovohet çdo vit.

Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës - Divizioni i prodhimit (KEK SHA) - TC Kosova B për prodhimin e energjisë elektrike zgjatet për periudhën nga 4 tetor 2006 deri më 4 tetor 2026 (numri i licencës ERO / Li_05 / 17_B) nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Ndërsa më 13 prill 2017, Licenca e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A), Divizioni i Prodhimit "TC Kosova B", me numër licence ZRRE / Li_05 / 14_B, është modifikuar në "Licencë e Kogjenerimit të Energjisë Elektrike dhe Termike" me numër të ri licence ZRRE / Libp_05 / 17_B lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), të gjitha dispozitat e tjera të licencës së mëparshme mbeten në fuqi.

Ndërsa më 20 dhjetor 2018, Korporatës Energjetike të Kosovës ishte pajisur me licencën e re ERO/ Li_60 / 17 për Furnizim me Energji Elektrike me vlefshmëri nga 20 dhjetor 2018 deri më 19 dhjetor 2043.

Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SHA) gjatë dhjetorit 2014 filloi projektin për Kogjenerimin e Energjisë Termike ku energjia termike i shitet Termokos Sh.A me qëllim të sigurimit të furnizimit me ngrohje në Prishtinë.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB").

2.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç për Pronat, impiantet dhe paisjet e blera para vitit 2005 të cilat mbahen me vlerë të drejtë, të cilat konsiderohen të jenë kosto në vitin e inkorporimit.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2.3 Supozimi i parimit të vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

2.4 Valuta funksionale dhe prezentimit

Valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë është euro (EUR) e cila është në pajtueshmëri me rregullativat e Unionit Monetar Europian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, valuta euro është adoptuar si valutë e vetme legale në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

Pasqyrat financiare janë përgaditur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse kërkohet të janë të shprehura ndryshe. Sipas nevojës, figurat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

2.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e denominuara në valuta ndryshe nga euro janë të regjistruara në kursin e këmbimit që vendoset në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të ndryshme nga euro, përfshihen në fitimin ose humbjen duke përdorur kursin e këmbimit që vendoset në atë datë.

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare ndryshe nga euro përkthehen me kursin e këmbimit të tregut të mesëm në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje pasi përkthimi i këmbimit valutor fiton më pak humbje.

2.6 Prona, impiantet dhe paisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe paisjeve më 1 Janr 2005 janë riparaqitur me koston e konsideruar zvogëluar zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, ndërsa zërat e pronës, impianteve dhe paisjeve të blera mbas periudhës 1 janar 2005 paraqiten me kosto zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimin, nëse ka.

Kostoja e konsideruar përfaqëson vlerat fillestare të pasurive të vlerësuara nga Kompania me ndihmën e një konsulenti të pavarur në kohën e shndërrimit nga një Korporatë në një Shoqëri Aksionare, më 1 janar 2005.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen fitimit ose humbjes gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Toka dhe pyjet mbahen sipas koston se vlerësuar dhe nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi në pasuritë e tjera është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, si vijon:

Toka në mihje	6 - 50 vite
Ndërtesat	10 - 50 vite
Paisjet e rënda industriale	8 - 20 vite
Automjetet	6 - 7 vite
Mobilje, armature dhe paisje	5 - 7 vite

Vlera e mbetur e pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar dhe rregulluar nëse ka qenë e përshtatshme, në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera bartëse e një pasurie është rritur menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se shumta e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të kufizuar të cilat fitohen veçmas, mbarten me kosto zvogëluar amortizimin e akumuluar dhe humbje të akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet mbi baza lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim, të cilat llogariten mbi bazën e ardhshme.

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të papërcaktuar që janë fituar veçmas, mbarten me kosto zvogëluar humbjet e akumuluar nga dëmtimi.

2.8 Mosnjohja e pasurive të paprekshme

Një pasuri e paprekshme nuk njihet në shitje ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose shitja. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një pasurie të paprekshme, maten si diferenca midis fitimit të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të pasurisë, njihen në fitim ose humbje kur pasuria është çregjistruar.

2.9 Dëmtimi i pasurive jo - financiare

Në secilën datë të raportimit, Kompania rishikon vlerat kontabël të pronës, impianteve dhe paisjeve dhe pasurive të paprekshme për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion që ato pasuri kanë pësuar një dëmtim nga humbjet. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet të përcaktojë masën e humbjes së dëmtimit (nëse ka). Kur pasuria nuk gjeneron fluks të parave që janë të pavarura nga pasuritë e tjera, Kompania vlerëson shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të parave të cilës i përket pasuria. Kur mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme e alokimit, pasuritë e korporatave u shpërndahen edhe njësive individuale të gjenerimit të parave, ose përndryshe ato shpërndahen në grupin më të vogël të njësive gjeneruese të parave për të cilat mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme të alokimit.

Shuma e rikuperueshme është më e larta se vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të parave zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për pasurinë për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parave nuk janë rregulluar.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie (ose njësi gjeneruese të parave të gatshme) vlerësohet të jetë më e vogël se vlera e tij kontabël, vlera kontabël e pasurisë (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) zvogëlohet në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje, përveç nëse pasuria përkatëse mbahet me një shumë të rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si një rivlerësim dhe në atë masë që humbja e dëmtimit është më e madhe se teprica e rivlerësimit të lidhur, humbja e tepërt nga dëmtimi njihet në fitim ose humbje.

Kur një humbje nga dëmtimi shfuqizon më pas, vlera kontabël e një pasurie (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) është rritur në vlerësimin e rishikuar të shumës së rikuperueshme të tij, por në mënyrë që vlera e shtuar kontabël të mos kalojë vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar nuk do të kishte asnjë humbje nga dëmtimi që do ishte njohur për pasurinë (ose njësinë gjeneruese të parave të gatshme) në vitet e mëparshme. Një kthim i humbjes nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje në atë mënyrë që eliminon humbjen nga dëmtimi i cili është njohur për pasurinë në vitet e mëparshme. Çdo rritje më të madhe se kjo shumë është trajtuar si një rritje të rivlerësimit.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.10 Investimet në burimet minerale

Një entitet trajton pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit si një klasë e veçantë të pasurive dhe jep informacionet shpjeguese të kërkuara nga SNK 16 Pronë, Impiante dhe SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Kompania i klasifikon pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit si të prekshme ose të paprekshme sipas natyrës së pasurisë të fituar dhe aplikon klasifikimin në mënyrë të vazhdueshme.

Një pasuri e eksplorimit dhe vlerësimit nuk klasifikohet më si i tillë kur fizibiliteti teknik dhe qëndrueshmëria tregtare e nxjerrjes së një burimi mineral janë të demonstrueshme. Pasuritë e kërkimit dhe vlerësimit vlerësohen për dëmtim, dhe çdo humbje nga dëmtimi e njohur, para riklasifikimit.

Shpenzimet që njihen si pasuri kërkimore dhe vlerësuese përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to:

- fitimi i të drejtave për të eksploruar;
- studime topografike, gjeologjike, gjeokimike dhe gjeofizike;
- shpimi eksplorues;
- gërmimi;
- mostra; dhe
- aktivitete në lidhje me vlerësimin e fizibilitetit teknik dhe qëndrueshmërinë tregtare të nxjerrjes së një burimi mineral.

Investimet në burimet minerale janë shpalosur në shënimin 4, Prona, impiantet dhe paisjet.

2.11 INSTRUMENTET FINANCIARE

Njohja dhe çregjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare, ose atëherë kur bëhet transferimi i pasurive financiare dhe të gjitha reziqeve dhe përfitimeve thelbësore. Një detyrim financiar çregjistrohet atëherë kur ai shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç të arkëtueshmeve tregtare të cilat nuk përmbajnë në vete përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmim të transaksionit në pajtueshmëri me SNRF 15, të gjitha pasuritë e tjera financiare fillimisht maten me vlerë të drejtë, të korrigjuar për kostot e transaksionit (aty ku është e zbatueshme). Pasuritë financiare, më përjashtim të pasurive financiare të paracaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kosto të amortizuara.
- vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si FVOCI dhe (FVTPL).

Klasifikimi përcaktohet nga të dyja:

- Modeli i biznesit së njësisë ekonomike në menaxhimin e pasurisë financiare.
- Karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare të cilat njihen në fitim ose humbje janë përfshirë brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të zhvlerësimit të të arkëtueshmeve tregtare, të cilat paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Matja e mëpasshme e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me kosto të amortizuar atëherë kur ato plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë të përcaktuara si FVTPL):

- ato janë të mbajtura brenda një modeli biznesor, qëllimi i së cilit është mbajtja e pasurive financiare dhe grumbullimi i flukseve monetare kontraktuale.
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare prodhojnë flukse të mjeteve monetare, pagesa e kryejës dhe interesit, të shumës kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto pasuri maten me kosto të amortizuar përmes metodës efektive të interesit. Zbritja nuk aplikohet atëherë kur efekti i zbritjes është jo material. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera përfshihen tek instrumentet financiare.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të grumbulluar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga pasuritë financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiare të kategorizuar si (FVTPL).

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Kompania llogarit Pasuritë financiare në FVOCI nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi objektiv i të cilit është "të mbajë mbledhjen" e flukseve monetare të lidhura dhe të shesë dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse (OCI) do të riciklohet pas mosnjohjes së pasurisë.

Në periudhat e paraqitura Kompania nuk ka asnjë pasuri financiar të kategorizuar si (FVOCI).

Zhvlerësimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritura të kreditit - 'modelin e pritur të humbjes kreditore (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe Pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, Pasuritë e kontratës të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe angazhimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditore nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes kreditore. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjes së humbjeve të pritura kreditore, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte Pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit. '12 - mujore humbjet e pritshme të kredisë 'njihen për kategorinë e parë, ndërsa' humbjet e pritshme të kreditit të jetës' njihen për kategorinë e dytë. Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Kompania përdor një qasje të thjeshtuar në kontabilizimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe regjistron kompensimin për humbjet si humbjet e pritshme të kreditit të jetës. Këto janë mangësitë e pritura në flukset e mjeteve monetare kontraktuale, duke pasur parasysh potencialin e mosplotësimit në çdo moment gjatë jetës së instrumentit financiar. Gjatë llogaritjes, kompania përdor përvojën e saj historike, treguesit e jashtëm dhe informacionin e ardhshëm për të llogaritur humbjet e pritshme të kredisë duke përdorur një matricë provizionit.

Kompania vlerëson zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare duke u bazuar në vlerësimin e menaxhmentit të humbjeve të pritshme të kredisë, duke marrë parasysh faktorë specifikë siç janë vjetërsia e bilancit, ekzistenca e mosmarrëveshjeve, modelet e pagesave historike të fundit dhe çdo informacion tjetër i disponueshëm në lidhje me besueshmërinë e palëve. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera janë të grupuara në bazë të të arkëtimit të kaluara dhe jo të kaluara. Referojuni tek shënimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe Shënimit të Riskut Kreditor për një analizë më të detajuar se si zhvlerësimi është llogaritur.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë të pagueshmet tregtare, huazimet dhe shpenzimet akruale.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Kompania ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.12 Matja e vlerës së drejtë

Kur një pasuri apo detyrim, financiar apo jo-financiar, matet me vlerën e drejtë për njohje ose dhënie informacionesh, vlera e drejtë bazohet në çmimin që do të merrej për të shitur një pasuri ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësit e tregut në datën e matjes; dhe supozon se transaksioni do të bëhet ose: në tregun kryesor; ose në mungesë të një tregu kryesor, në një treg më të favorshëm.

Vlera e drejtë matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdorin kur çmimi i pasurisë ose detyrimit, supozohet se veprojnë në interesat e tyre më të mirë ekonomik. Për pasuritë jo-financiare, matja e vlerës së drejtë bazohet në përdorimin e saj më të lartë dhe më të mire. Teknikat e vlerësimit që janë të përshtatshme për rrethanat dhe për të cilat të dhënat të mjaftueshme janë në dispozicion për të matur vlerën e drejtë, janë përdorur, duke maksimizuar përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizuar përdorimin e inputeve të paverifikueshme.

Pasuritë dhe detyrimet e matura me vlerën e drejtë klasifikohen në tre nivele, duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e inputeve të përdorura në bërjen e matjeve. Klasifikimet rishikohen në çdo datë raportimi dhe transferimet ndërmjet niveleve përcaktohen bazuar në rivlerësimin e nivelit më të ulët të inputit që është i rëndësishëm për matjen e vlerës së drejtë.

Për matjet e përsëritura dhe jo të përsëritura të vlerës së drejtë, vlerësuesit e jashtëm mund të përdoren kur ekspertiza e brendshme ose nuk është e disponueshme ose kur vlerësimi vlerësohet të jetë i rëndësishëm. Vlerësuesit e jashtëm zgjidhen bazuar në njohuritë dhe reputacionin e tregut. Kur ka një ndryshim të rëndësishëm në vlerën e drejtë të një pasurie ose detyrimi nga një periudhë në tjetrën, është ndërmarrë një analizë, e cila përfshin një verifikim të inputeve kryesore të përdorura në vlerësimin e fundit dhe një krahasim, kur është e aplikueshme, me burimet e jashtme të të dhënave.

2.13 Klasifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë

Pasuritë dhe detyrimet janë të paraqitura në pasqyrën e pozitës financiare duke u bazuar në klasifikimin afatshkurtër dhe afatgjatë.

Një pasuri klasifikohet si afatshkurter kur: ose pritët të realizohet prej saj ose qëllimi është për t'u shitur ose për t'u konsumuar në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritët të realizohet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose pasuria është para apo ekuivalent i parasë përveç nëse ndalohet për t'u këmbyer apo për t'u përdorur për kryerjen e një detyrimi për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha pasuritë tjera klasifikohen si afatgjata.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur: ose pritët të kryhet në ciklin normal operativ; mbahet për qëllime primare të tregtimit; pritët të kryhet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese; ose nuk ka të drejtë të pakushtëzuar për t'a shtyer kryerjen e detyrimit për më së paku 12 muaj pas periudhës raportuese. Të gjitha detyrimet tjera klasifikohen si afatgjata. Tatimi i shtyrë si pasuri dhe detyrime gjithnjë klasifikohet si afatgjatë.

2.14 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshinë paranë e gatshme, depozitat në të pare dhe investimet e tjera shumë likuide afatshkurtra të cilat janë lehtë të konvertueshme në një shumë të njohur të parave dhe janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë.

2.15 Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare janë fillimisht të njohura me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë lejim për humbjet e pritura të kreditit. Të arkëtueshmet tregtare në përgjithësi janë për t'u kryer brenda 30 deri 60 ditë.

Kompania ka aplikuar një qasje të thjeshtuar për matjen e humbjeve të pritura të kreditit, që përdor një lejim për humbjet e pritura gjatë jetëgjatësisë. Për të matur humbjet e pritura të kreditit, të arkëtueshmet tregtare janë grupuar në bazë të ditëve të vonesës. Të arkëtueshmet tjera janë njohur sipas koston së amortizimit, minus ndonjë lejim për humbjet e pritura të kreditit.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.16 Inventarët

Materialet, pjesët rezervë dhe të konsumit, kryesisht lidhen me termocentratin dhe minieren, dhe janë vlerësuar me koston më të ulët të dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e bëra në blerjen e inventarëve dhe sjelljen e tyre në vendin e tyre dhe kushtet aktuale. Vlera e realizueshme neto është cmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhjen normale të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variabile të shitjes. Materialet dhe pjesët rezerve shpenzohen apo kapitalizohen në pasurinë materiale të përshtatshëm kur instalohen. Një provizion për inventar me levizje të ngadalshme dhe të vjetërsuara (përfshijë qymyrin dhe karburantet) njihet në fitim ose humbje, bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhmentit.

Linjiti: Kompania nxjerr linjitin e saj i cili është përdorur në procesin e prodhimit për gjenerimin e energjisë elektrike në termocentralet e saj, e cila punon në dy minierat. Rezervat e linjtit janë paraqitur në kosto, e cila përfshin koston direkte të nxjerrjes dhe një pjesë përkatese të shpenzimeve indirekte që janë shkaktuar me nxjerrjen e tij.

2.17 Huazimet

Kostot e huamarrjes që lidhet drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një pasurie të kualifikuar janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të përfunduar dhe përgatitur pasurinë për qëllim përdorimi ose shitjeje, i shtohen kostot e atyre pasurive, deri në kohën kur pasuritë janë në thelb të gatshme për përdorimin ose shitjen e synuar të tyre.

Në atë masë që huazimet me normë të ndryshueshme përdoren për të financuar një pasuri të kualifikuar dhe mbrohen në një mbrojtje efektive të rrjedhës së parasë së rrezikut të normës së interesit, pjesa efektive e derivatit njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe riklasifikohet në fitim ose humbje kur pasuria kualifikues ndikon në fitimin ose humbjen. Në atë masë që huazimet e normës fikse përdoren për të financuar një pasuri të kualifikuar dhe mbrohen në një mbrojtje efektive të vlerës së drejtë të rrezikut të normës së interesit, kostot e huamarrjes së kapitalizuar reflektojnë normën e interesit të mbrojtur.

Të ardhurat nga investimet të fituara nga investimi i përkohshëm i huazimeve specifike në pritje të shpenzimeve të tyre për pasuritë kualifikuese, zbriten nga kostot e huamarrjes të përshtatshme për kapitalizim. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

2.18 Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Këto shuma përfaqësojnë detyrime për mallrat dhe shërbimet që i ofrohen kompanisë para fundit të vitit financiar dhe të cilat janë të papaguara. Për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ato maten me koston e amortizuar dhe nuk zbriten. Shumat janë të pasigurta dhe zakonisht paguhen brenda 30 ditëve nga njohja.

2.19 Detyrimet e kontratës

Detyrimet e kontratës përfaqësojnë detyrimin e kompanisë për të transferuar mallra ose shërbime te një klient dhe njihen kur një klient paguan shumën, ose kur kompania njih një të arkëtueshme për të pasqyruar të drejtën e saj të pakushtëzuar në konsideratë (cila është më e hershme) para se kompania të ketë transferuar mallrat ose shërbimet ndaj klientit.

2.20 Njohja e të hyrave

Kompania i njih të hyrat si më poshtë:

Të hyrat nga kontratat me klientët

Shitja njihet në shumën që reflekton vlerësimin për të cilën kompania pritët të jetë e thirrur në shkëmbimin e të mirave apo shërbimeve te klienti. Për çdo kontratë me klient, kompania: identifikon kontratën me klientin; identifikon obligimet në kontratë; përcakton çmimin e transaksionit që merr në llogari vlerësimet e ndryshme dhe vlerën në kohë të parasë; alokon çmimin e transaksionit për detyrimet e veçanta në bazë të çmimit të shitjes së pavarur të çdo malli apo shërbimi që do të dërgohet; dhe njih të hyrat kur ose secili obligim është përfunduar në një mënyrë që përshkruan transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Vlerësimet e ndryshme brenda çmimit të transaksionit, nëse ka, reflektojnë konçesionet të siguruara te klienti siç janë zbritjet, rabatet dhe rimbursimet, çdo bonus potencial i arkëtueshëm nga klienti dhe çdo ngjarje tjetër kontingjente. Vlerësimet e tilla përcaktohen duke përdorur ose metodën e 'vlerës së pritur' ose metodën e 'vlerës më të mundshme për të ndodhur'. Matja e vlerësimeve të ndryshme i nënshtrohet një parimi kufizues prej ku shitja do të njihet vetëm deri në shkallën që është shumë e mundshme që një kthim domethënës në vlerën e grumbulluar të shitjes nuk do të ndodhë. Vlerësimi i kufizuar vazhdon derisa pasiguria e shoqëruar me vlerësimin e ndryshëm zgjidhet më pas. Shumat e pranuar që i nënshtrohen parimit të kufizuar njihen fillimisht si të hyra të shtyra në formë të një detyrimi të ndarë rimbursues.

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike njihen kur u ofrohet energji elektrike konsumatorëve. Faturimi për shitjet e energjisë elektrike bëhet çdo muaj, brenda pesë (5) ditëve të muajit pas muajit në të cilin kryhet konsumi i energjisë elektrike.

Të ardhurat nga shitja e thëngjillit

Shitja e thëngjillit njihet në pikën e shitjes, e cila është aty ku klienti ka marrë dorëzimin e të mirave, rreziqet dhe shpërblimet transferohen te konsumatori dhe ekziston një kontratë e vlefshme shitje.

Interesi

E hyra nga interesi është njohur kur interesi ndodh duke përdorur metodën e interest efektiv. Kjo është një metodë e kalkulimit të kostos së amortizuar së një pasurie financiare dhe e alokimit të hyrave të interesit nëpër periudhën relevante duke përdorur normën e interesit efektiv, normë e cila saktësisht zbret pranimet e pasasë të parashikuara përmes pritshmërisë së pasurisë financiare për vlerën neto kontabël të pasurisë financiare.

Qiraja

Të ardhurat nga qiraja njihen mbi bazën lineare gjatë afatit të qirasë. Motivët e dhëna me qira njihen si pjesë e të ardhurave nga qiraja. Qiraja e kontigjente njihet si e ardhur në periudhën kur fitohen.

Të ardhurat tjera

Të ardhurat tjera njihen kur pagesa pranohet apo kur e drejta për të pranuar pagesën është krijuar.

Të ardhurat nga jobalancat

Të ardhurat nga imbalancat (pozitive) krijohen në rastin kur realizimi i prodhimit për orë të caktuara tejkalon planifikimin e prodhimit dhe në sistem krijohet një imbalance pozitive (devijim) dhe në këto rrethana energjia shtyhet në sistem dhe faturohet si sasi të energjisë së devijuar. shumëzuar me çmimin fiks për orë të aksioneve HUPLEX shumëzuar me faktorin 0.7.

Të ardhurat nga Kogjenerimi

Të ardhurat nga shitjet e energjisë termike njihen kur energjia u jepet klientëve. Faturimi për shitjet e energjisë elektrike bëhet çdo muaj brenda pesë (5) ditëve të muajit pas muajit në të cilin kryhet konsumi i energjisë elektrike.

Të ardhurat nga shkëmbimi i energjisë

Shkëmbimi i energjisë elektrike bëhet për të mbështetur palët e përfshira në këtë marrëveshje (KEK dhe KESH) si në rastin e Importit apo edhe eksportit. Kur KEK-u ka teprica të energjisë elektrike që nuk mund t'i vendosë në treg, atëherë i kërkon KESH t'i depozitojë ato dhe anasjelltas, kur KESH ka teprica të energjisë elektrike për shkak të rritjes së nivelit të ujit, atëherë i kërkon KEK-ut që të depozitojë energji elektrike. Në raste të tjera kur secila palë është në gjendje emergjente dhe duhet të marrë energji nga pala tjetër, atëherë ia paraqet kërkesën palës tjetër me arsyeshmëri dhe kohëzgjatje. çmimi i këmbimit të energjisë elektrike bazohet në një çmim mesatar të energjisë elektrike dhe njihet si e ardhur / shpenzim në periudhën në të cilën ndodh shkëmbimi i energjisë elektrike.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.21 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë njohur në pasqyrën e të ardhurave pas pranimit të shërbimeve ose në momentin kur nododhin.

2.22 Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes kryesisht përbëhen nga interesi për huazimet e Kompanisë. Kostot e huamarrjes që lidhet drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një pasurie të kualifikuar janë kapitalizuar gjatë periudhës kohore që është e nevojshme për të përfunduar dhe përgatitur pasurinë për qëllim përdorimi ose shitjeje. Kostot e tjera të huamarrjes janë shpenzuar në periudhën në të cilën ato janë kryer dhe raportuar si "Kostot financiare".

2.23 Kostot e përfitimeve për pensione

Kontributet pensionale

Kompania nuk jep asnjë provizion dhe nuk ka asnjë detyrim për pensionet e punonjësve mbi dhe për kontributet e paguara në planin e pensionit të detyrueshëm të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

2.24 Tatimi

Tatimi është kalkuluar në pasqyrat financiare në përputhshmëri me ligjin aktual në fuqi të Kosovës mbi tatimet, Ligji nr. 06/L-105 "Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave". Norma e tatimit mbi të ardhurat e tatueshme të korporatave është 10%.

Tatimi aktual

Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi siç raportohet në fitimin ose humbjen sepse përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe më tej përjashton zëra që nuk janë kurrë të tatueshëm ose të zbritshëm. Përgjegjësia e kompanisë për tatimin aktual llogaritet duke përdorur tarifat tatimore që janë aprovuar në mënyrë thelbësore ose thelbësore deri në fund të periudhës së raportimit. Një provizion është e njohur për ato çështje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt, por konsiderohet e mundshme që do të ketë një rrjedhje të ardhshme të fondeve tek një autoritet tatimor. Provizionet maten në vlerësimin më të mirë të shumës që pritet të paguhet. Vlerësimi bazohet në gjykimin e profesionistëve të tatimeve brenda Kompanisë bazuar në përvojën e kaluar me këto aktivitete dhe në raste të caktuara në bazë të këshillave të pavarur të këshillimit tatimor.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në ndryshimet midis vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës përkatëse tatimore të përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe llogariten për përdorimin e metodës së bilancit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen përgjithësisht për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe pasuritë tatimore të shtyra njihen në atë masë sa është e mundshme që fitimet e tatueshme do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Vlera kontabël e pasurive tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe zvogëlohet në atë masë sa nuk është më e mundshme që fitimet e mjaftueshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të lejuar që të gjithë ose një pjesë e pasurisë të rikuperohet.

Tatimi i shtyrë llogaritet në normat e tatimeve që pritet të zbatohen në periudhën kur detyrimi shlyhet ose pasuria realizohet. Tatimi i shtyrë është ngarkuar ose kredituar për fitim ose humbje, përveç kur ka të bëjë me zërat e ngarkuar ose kredituar drejtpërdrejt në ekuitetin e vet, si PPE të rivlerësuar më parë të trajtuar si kosto e vlerësuar për kalimin në SNRF, në këtë rast tatimi i shtyrë gjithashtu trajtohet në ekuitet.

Matja pasuese e detyrimit tatimor të shtyrë llogaritet gjithashtu në ekuitet si të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar pasuritë tatimore aktuale ndaj detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me taksat e të ardhurave të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor dhe Kompania synon të shlyejë pasuritë dhe detyrimet e tanishme tatimore në baza neto. Kompania nuk e njeh pasuri tatimore të shtyrë në provizione duke përfshirë provizionin e arkëtueshme pasi konsideron se është për shkak të pasigurisë së trajtimit tatimor në periudhat e ardhshme.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe i shtyrë njihet në fitim ose humbje, përveç kur lidhet me zërat e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt me ekuitetin, në të cilin rast tatimi aktual dhe i shtyrë njihet edhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose të ardhura neto nga ekuiteti.

2.25 Grantet qeveritare

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ketë një siguri të arsyeshme që Kompania do të respektojë kushtet e bashkangjitura me to dhe që atëherë grantet do të merren.

Grantet qeveritare njihen në fitim ose humbje mbi baza sistematike gjatë periudhave në të cilat Kompania njih si shpenzime kostot e lidhura për të cilat grantet kanë për qëllim të kompensojnë. Në mënyrë të veçantë, grantet qeveritare gjendja kryesore e të cilave është që Kompania të blejë, ndërtojë ose përvetësojë ndryshe pasuritë afatgjata (përfshirë pronën, impiantet dhe pajisjet) njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar dhe transferohen në fitim ose humbje në një bazë sistematike dhe racionale mbi jetën e dobishme të pasurive të lidhura.

Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet e bëra tashmë ose me qëllim të dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për Kompaninë pa kosto të lidhura me të ardhmen, njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

Përfitimi i një kredie qeveritare me një normë interesi nën atë të tregut trajtohet si një grant qeveritar, i matur si diferenca midis të ardhurave të marra dhe vlerës së drejtë të kredisë bazuar në normat e interesit mbizotërues të tregut.

Grantet qeveritare ndaj kostove të riedukimit të stafit njihen si të ardhura gjatë periudhave të nevojshme për t'i përputhur ato me kostot e lidhura dhe zbriten në raportimin e shpenzimeve përkatëse.

2.26 Tatimi mbi vlerën e shtuar

Të ardhurat, shpenzimet njihen neto nga shuma e tatimit mbi vlerën e shtuar, përveç kur tatimi mbi vlerën e shtuar nga blerja e pasurive ose shërbimeve nuk është e rimbursueshme nga organet tatimore, në të cilin rast vlera e shtuar është e njohur si pjesë e shpenzimeve për blerje ose si pjesë e kostos sipas rastit; dhe

Shuma neto e TVSH-së e cila është e rikuperueshme, ose që duhet paguar te autoritetet tatimore është përfshirë si pjesë e arkëtueshme ose detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.27 Ekuiteti

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbëhet nga 25,000 aksione të zakonshme me 1 (një) euro për aksion. Aksionari i vetëm i Kompanisë është Qeveria e Kosovës.

Rezervat

Rezervat janë llogaritur fillimisht në librat e Kompanisë si diferencë midis kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës së pasurive neto të Kompanisë siç përcaktohet nga vlerësimi i pavarur në datën e themelimit të saj si SH.A. (1 janar 2005). Këto rezerva hiqen në dispozicion të pasurive të lidhura. Më tej, këto rezerva nuk janë të disponueshme për shpërndarje tek aksionari.

Rezervat përfshijnë gjithashtu efektin e taksës së shtyrë (lëshimin e detyrimit tatimor të shtyrë) të krijuar fillimisht në bazë të rivlerësimit të pasurisë, bimëve dhe pajisjeve pas kalimit në SNRF.

Humbjet e akumuluar

Humbjet e akumuluar janë rregulluar më 1 janar 2005 si rezultat i një due diligence të kryer nga Deloitte Evropa Qendrore. Humbjet e akumuluar u rregulluan për: humbjet nga dëmtimi i PPE, humbjet nga dëmtimi i arkëtimit, humbjet nga dëmtimi i inventarit, provizioni për detyrimet mjedisore, provizioni për fondet e pensionit etj.

Nga 2005 e tutje Humbjet e akumuluar debitoohen / kreditohen për humbjet ose fitimin e vitit.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.28 Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një obligim aktual si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, dhe është e mundur se një rrjedhje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer obligimin, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së obligimeve.

Shuma e njohur si provizion është vlerësimi më i mirë i vlerës së kërkuar për shlyerjen e detyrimit aktual në datën e raportimit, duke marrë parasysh rreziqet dhe paqartësitë rreth detyrimit. Kur një provizion matet duke përdorur flukset e parave të vlerësuara për të shlyer detyrimin aktual, vlera e tij kontabël është vlera aktuale e atyre flukseve monetare (kur efekti i vlerës kohore të parasë është material).

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion pritet të rikuperohen nga një palë e tretë, një e arkëtueshme njihet si pasuri, nëse është praktikisht e sigurt që rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet me besueshmëri.

Provizionet në lidhje me pastrimin dhe rikuperimin e tokës

Bilanci i provizionit paraqet vlerësimin më të mirë të kompanisë për kostot që lidhen me pastrimin dhe rikuperimin e tokës, heqjen e deponive të hirit dhe dekomisionimin nga puna të fabrikës së gazifikimit nga vendet e gjenerimit të energjisë. Këto kosto bazohen në vlerësimet e brendshme të menaxhmentit, ku menaxhmenti beson se afatet e fluksit të parave në këtë drejtim do të jenë 3-10 vite. Ndërsa bëhen vlerësime të provizionit, Kompania shfrytëzoi të gjithë faktorët e lidhur, përfshirë ofertat e mundshme për projekte të tilla, kohën e parashikuar të fluksit të parave dhe informacione të tjera të lidhura me tregun.

Provizionet në lidhje me paaftësinë e personelit

Provizionet njihen në pasqyrat financiare të Kompanisë për pagesa që lidhen me pensionet shtesë dhe qiratë që paguhen bazuar në vendimet gjyqësore për punonjësit e dëmtuar në vendin e punës dhe kanë humbur aftësinë e tyre për të punuar dhe anëtarëve të familjes së tyre në rast se punonjësi ka vdekur në vendin e punës. Menaxhmenti bën vlerësime vjetore në lidhje me bilancin që duhet të llogariten në lidhje me detyrimin e Kompanisë për pagimin e pensioneve shtesë dhe qirave.

Provizionet Jubilare

Kompania nuk ka njohur provizione për detyrat e pagave Jubilare për vitet 2015-2017. Pas ngjarjeve që ndodhin në vitin 2018, kompania është e detyruar të paguajë në disa raste detyrimin për pagat jubilarë. Menaxhmenti i Kompanisë ka rivlerësuar provizionet për pagën e Jubilare dhe është arritur në përfundimin se një provizion shtesë duhet të njihet në pasqyrat financiare të kompanisë deri më 31 dhjetor 2018. Gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2019, kompania njohu shpenzimet e bëra për kostot e pagave jubilarë në vit në të cilin të punësuarit kanë të drejtë të kompensohen.

2.29 Palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura janë ato kur njëra nga palët kontrollohet nga tjetra ose ka ndikim të rëndësishëm në marrjen e vendimeve financiare ose të biznesit të palës tjetër.

2.30 Zotimet dhe Kontigjentet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveç nëse një rrjedhje e mundshme e burimeve që materializojnë përfitimet ekonomike është e largët. Pasuritë kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur një rrjedhje e beneficioneve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, detyrimin e pësuar në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

2.31 Ngjarjet pas datës raportuese

Ngjarjet mëpasshme që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Kompanisë, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas periudhës raportuese që nuk janë ngjarje rregulluese shpalosen në shënime nëse janë materiale.

2.32 Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të miratuara

Kompania ka zbatuar të gjithë Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('IASB') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Çdo standard ose interpretim i kontabilitetit i ri ose i ndryshuar që nuk është ende i detyrueshëm nuk është miratuar më herët. Zbatimi i këtyre standardeve dhe interpretimeve nuk kishte ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- Ndryshimet në SNRF 3 Përkufizimi i një biznesi;
- Ndryshimet në SNRF 7, SNRF 9 dhe SNK 39 Reforma e Vlerësimit të Interesit;
- Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 Përkufizimi i Materialit;
- Ndryshimet në SNRF 16, shtyerjet në lidhje me COVID-19;
- Korniza Konceptuale për Raportimin Financiar.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

3. GJYKIMET KRITIKE NË APLIKIMIN E POLITIKAVE TË KONTABILITETIT TË KOMPANISË

Nuk ka gjykime kritike, përveç atyre që përfshijnë vlerësime (shiko 3.1 më poshtë), që menaxhmenti ka bërë në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Kompanisë dhe që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në këto pasqyra financiare.

3.1 Burimet kryesore për vlerësimin e pasigurisë

Në vijim janë supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në fund të periudhës raportuese, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të mbajtjes së pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Zhvlerësimi dhe jetëgjatësia funksionale e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Pasuritë e kompanisë përbëhen nga instalime të mëdha dhe komplekse. Ato janë të shtrenjta për t'u ndërtuar, prirjen të jenë të ekspozuar ndaj kushteve të vështira operative dhe kërkojnë zëvendësim ose riparim periodik. Pasuritë gjeneruese përbëhen nga një numër i konsiderueshëm i komponentëve, shumë prej të cilëve do të kenë jetëgjatësi të ndryshme. Siç përshkruhet në shënimin 2.6 më lart, Kompania rishikon jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar të pasurisë, impianteve dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave ose faktor tjetër mund të ndikojë në jetëgjatësinë e dobishme të pasurive dhe, në përputhje me rrethanat, mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën kontabël të atyre pasurive.

Lejimet nga humbjet e pritshme kreditore

Lejimet për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Bazohet në humbjen e pritshme të jetëgjatësisë, e grupuar në bazë të arketimeve të prapambetura dhe jo të detyrueshme dhe bën supozime për të ndarë një normë të përgjithshme të pritshme të humbjes kreditore për secilin grup. Këto supozime përfshijnë përvojën e shitjeve të fundit dhe nivelet e mbledhjes historike.

Provizionimi për dëmtimin e inventarit

Vlerësimi për provizionim për dëmet e inventarit kërkon një shkallë vlerësimi dhe gjykimi. Menaxhmenti bën vlerësimin e dëmit të inventarit bazuar në lëvizjen e inventarit gjatë vitit. Bilanci i dëmtimeve llogaritet çdo fundvit dhe sigurohet inventari që nuk ka lëvizur për 365 ditë provizionohet.

Provizionet në lidhje me përfitimet e stafit

Provizionet njihen në pasqyrat financiare të kompanisë për pagesa në lidhje me pensionet plotësuese dhe qiratë paguhen bazuar në vendimet gjyqësore, për personat e dëmtuar në vendin e punës që kanë humbur aftësinë për të punuar dhe për anëtarët e familjes së tyre në rast se personi ka vdekur në vendin e punës. Menaxhmenti bën vlerësime vjetore në lidhje me bilancin që duhet të llogariten në lidhje me detyrimin e kompanisë për pagimin e pensioneve shtesë dhe qirave.

Vlerësimi i çështjeve gjyqësore

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësimin për shumat e shlyerjes së çështjeve gjyqësore të udhëhequra nga këshilltari juridik i Kompanisë. Mbi bazën e këtij vlerësimi, Kompania në përputhje me rrethanat regjistron provizionet, nëse ka, ose shpalos përgjegjësinë e mundshme. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Vlerësimi për çështje mjedisore, dekomisionim dhe çështje të tjera të lidhura

Aktualisht nuk ka kërkesë ligjore detyruese për dispozitat mjedisore, dekomisionimin dhe dispozitat e tjera të lidhura me të në Kosovë. Kompania rregullisht kryen vlerësimet e saj të brendshme për provizione të tilla dhe i njeh ato në varësi të natyrës dhe rrethanave përreth këtyre dispozitave. Në varësi të natyrës dhe madhësisë së operacioneve të Kompanisë në të ardhmen dhe më tej nga çdo ndryshim i mundshëm në kornizën ligjore në Kosovë, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet e Kompanisë.

Tatimet

Detyrimi tatimor i Kompanisë për aktivitetet operative është shuma e gjithsej detyrimeve tatimore aktuale. Llogaritja e gjithsej tatimit të Kompanisë përfshin domosdoshmërisht një shkallë vlerësimi dhe gjykimi në lidhje me zëra të caktuar, trajtimi tatimor i të cilave nuk mund të përcaktohet përfundimisht derisa të arrihet një zgjidhje me autoritetin përkatës tatimor ose, sipas rastit të jetë, përmes një procesi zyrtar juridik. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të ketë një ndikim material në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe / ose variancave në rrjedhën e parave.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Shënimet për pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

3. GJYKIMET KRITIKE NË APLIKIMIN E POLITIKAVE TË KONTABILITETIT TË KOMPANISË (VAZHDIM)

Pandemia e koronavirusit (COVID-19)

Gjykimi është ushtruar në marrjen në konsideratë të ndikimeve që pandemia e Koronavirusit (COVID-19) ka pasur, ose mund të ketë në Kompaninë, bazuar në informacionin e njohur. Kjo konsideratë shtrihet në natyrën e produkteve të ofruara, klientëve, personelit dhe rajonit në të cilin Kompania operon. Aktualisht nuk duket të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare ose ndonjë pasiguri të konsiderueshme në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të ndikojnë në mënyrë të pafavorshme në Kompaninë në datën e raportimit ose më pas si rezultat i pandemisë së Koronavirusit (COVID-19).

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

4. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET

	Toka dhe pyjet	Toka në miniera	Ndërtesat	Pajisjet	Ndërtimet në zhvillim e sipër	Gjithsej
	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Kosto/Kostot e konsideruara:						
Më 1 Janar 2019	11,489	59,719	43,241	618,659	8,315	741,423
Shtesat	-	88	1,333	23,752	9,280	34,453
Shlyerjet	-	-	(150)	(233)	-	(383)
Transferet e brendshme	-	-	492	5,335	(5,827)	-
Transferet në Inventar	-	-	-	-	(235)	(235)
Më 31 Dhjetor 2019	11,489	59,807	44,916	647,513	11,533	775,258
Më 1 Janar 2020	11,489	59,807	44,916	647,513	11,533	775,258
Shtesat	-	15,392	1,943	10,758	8,630	36,723
Shlyerjet	-	-	(1,220)	(1,334)	-	(2,554)
Transferet e brendshme	-	-	287	7,728	(8,015)	-
Transferet në Inventar	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2020	11,489	75,199	45,926	664,665	12,148	809,427

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

4. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET (VAZHDIM)

	Toka dhe pyjet	Toka në miniera	Ndërtesat	Pajisjet	Ndërtimet në zhvillim e sipër	Gjithsej
	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Zhvlerësimi i akumuluar:						
Më 1 Janar 2019	-	24,709	21,961	381,589	-	428,259
Shtimet për vitin	-	5,890	1,516	34,404	-	41,810
Heqja e pasurive të shlyera	-	-	(138)	(228)	-	(366)
Më 31 Dhjetor 2019	-	30,599	23,339	415,765	-	469,703
Më 1 Janar 2020	-	30,599	23,339	415,765	-	469,703
Shtimet për vitin	-	5,961	1,821	37,870	-	45,652
Heqja e pasurive të shlyera	-	-	(975)	(1,318)	-	(2,293)
Më 31 Dhjetor 2020	-	36,560	24,185	452,317	-	513,062
Vlera neto në libra:						
Më 31 Dhjetor 2019	11,489	29,208	21,577	231,748	11,533	305,555
Më 31 Dhjetor 2020	11,489	38,639	21,741	212,348	12,148	296,365

Të përfshira në Pronë, Impiante dhe Pajisjet, nën kategorinë Ndërtimet në Vijim, janë investimet në burime minerale për minierën e re në vlerë prej 2,599 mijë euro më 31 dhjetor 2020 (31 dhjetor 2019; 2.599 mijë euro).

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, pajisjet dhe pasuritë minerare të Kompanisë janë kolateralizuar kundër huazimeve nga huatë nga Ministria e Financave (shiko Shënimin 11).

Të përfshira në "pronat" dhe "ndërtesat" janë disa prona, të cilat janë nën kontrollin e Kompanisë, por për të cilat Kompania nuk posedon dokumentacionin e duhur të pronësisë. Kompania është në proces të zgjidhjes së çështjes dhe të kompletojë dokumentacionin me ndihmën e Qeverisë së Kosovës.

Ndikimi Covid-19

Një nga ndikimet e Covid-19 në Pronë, Impiante dhe Pajisje ishte shtyrja për 2022/2023 e implementimit të donacionit të BE-së për projektin e Elektro-filtrave dhe projekteve të tjera që lidhen me këtë në drejtim të mbylljes së termocentraleve.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**Shënimet për pasqyrat financiare****Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020****5. PASURITË E PAPREKSHME**

Pasuritë e paprekshme në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	Softueri (në EUR '000)	Softueri në përgatitje (në EUR '000)	Gjithsej (në EUR '000)
Kosto/Kostot e konsideruara:			
Gjendja më 1 Janar 2019	247	-	247
Shtesa gjatë vitit	4	-	4
Transferet	30	-	30
Shlyerjet	(1)	-	(1)
Gjendja 31 Dhjetor 2019	280	-	280
Shtesa gjatë vitit	-	187	187
Transferet	-	-	-
Shlyerjet	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2020	280	187	467
Amortizimi i akumuluar:			
Gjendja më 1 Janar 2019	231	-	231
Amortizimi për vitin	6	-	6
Shlyerjet	(1)	-	(1)
Gjendja 31 Dhjetor 2019	236	-	236
Amortizimi për vitin	10	-	10
Shlyerjet	-	-	-
Gjendja 31 Dhjetor 2020	246	-	246
Vlera neto në libra më 31 Dhjetor 2019	44	-	44
Vlera neto në libra më 31 Dhjetor 2020	34	187	221

6. INVENTARËT

Inventarët në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	2020 (në EUR '000)	2019 (në EUR '000)
Materialet dhe materialet harxhuese	26,577	27,625
Linjit	3,891	6,010
Karburant	1,416	1,870
Pjesë ndërrimi	15,125	14,591
Të tjera	11,903	10,267
	58,912	60,363
Provizionimi për inventarët e vjetësuar	(39,071)	(39,638)
	19,841	20,725

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**Shënimet për pasqyrat financiare****Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020****6. INVENTARËT (VAZHDIM)**

Lëvizjet në llogarinë e provizionimit të inventarit paraqiten si më poshtë:

	2020	2019
	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Gjendja më 1 Janar	(39,638)	(40,848)
Ngarkesa për periudhën	-	-
Lirimi i provizionit	567	1,210
Gjendja më 31 Dhjetor	(39,071)	(39,638)

7. TË ARKËTUESHMET TREGTARE DHE TË TJERA

Të arkëtueshmet tregtare në pasqyrën e pozicionit financiar analizohen si më poshtë:

	2020	2019
	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Të arkëtueshme tregtare:		
Konsumatorët vendor	42,763	30,049
Konsumatorë të huaj	4,510	4,927
Interesi akrual nga KEDS dhe KESCO	883	-
	48,156	34,976
Minus Lejimet (shih Shënimin 27.B)	(13,873)	(16,706)
	34,283	18,270
Të arkëtueshmet tjera dhe avancet:		
Avancet ndaj furnitorëve	5,616	4,361
TVSH e arkëtueshme	-	372
Garancioni bankar	10	316
Të arkëtueshmet tjera	1,584	991
	7,210	6,040
Minus Lejimet për të arkëtueshmet tjera dhe avancet (Shënimi 27.B)	(643)	(1,696)
Gjithsej të arkëtueshmet tjera	6,567	4,344
Gjithsej	40,850	22,614

Të arkëtueshme tregtare janë shuma për tu paguar nga klientët për shitje të energjisë elektrike, avullit të kogjenerimit, qymyrit etj në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Të arkëtueshmet tregtare zakonisht pranohen brenda 30 ditësh dhe për këtë arsye klasifikohen të gjitha si afatshkurtra. Llogaritë e arkëtueshme dhe paradhëniet e tjera janë të përbëra nga paradhëniet që u janë dhënë furnitorëve për punë dhe shërbime që duhen kryer, ndërsa arkëtimet e tjera janë shuma për shkak të klientëve për shërbimet e kryera. Për analiza të mëtejshme mbi lejimin e zhvlerësimit dhe rrezikun e kredisë, ju lutemi referojuni Shënimit 27.B.

Interesi akrual nga KEDS dhe KESCO përfaqëson të arkëtueshmen në lidhje me pagesat e vonuara të faturave të energjisë elektrike nga KEDS / KESCO.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**Shënimet për pasqyrat financiare****Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020****8. PARAJA NË DORË DHE NË BANKË**

	2020	2019
	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Llogaritë rrjedhëse në banka	67,924	67,201
Parja në dorë	4	6
	67,928	67,207

9. KAPITALI AKSIONAR

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 dhe sipas Regjistrimit të Biznesit të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë nën Reg. Nr. 70325399, kapitali i përgjithshëm i pajtuar arrin në 25 mijë euro. Përmban 25,000 aksione të zakonshme me 1 (një) euro për aksion. Aksionari i vetëm i Kompanisë është Qeveria e Kosovës.

10. REZERVAT

Rezervat, të cilat më 31 dhjetor 2020 kapin shumën 568,784 mijë euro (2019: 568,538 mijë euro) fillimisht janë llogaritur në librat e Kompanisë, si diferencë midis kapitalit të regjistruar të aksioneve dhe vlerës së pasurive neto të Kompanisë, siç përcaktohet nga vlerësimi i pavarur në data e përfshirjes së saj si SHA (1 janar 2005). Këto rezerva hiqen nga shitja e pasurive të lidhura. Më tej, këto rezerva nuk janë të disponueshme për shpërndarje tek aksionari.

Rezervat përfshijnë gjithashtu efektin e tatimit të shtyrë (lëshimin e detyrimit tatimor të shtyrë) të krijuar fillimisht në bazë të rivlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve pas kalimit në SNRF.

11. HUAZIMET

Kompania ka marrë hua afatgjata dhe afatshkurtra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si më poshtë:

	2020	2019
	(në EUR '000)	(në EUR '000)
Pjesa afatgjatë		
Kredi me interes nga Ministria e Financave	138,154	149,541
	138,154	149,541
Pjesa afatshkurtër		
Kredi me interes nga MF - Pjesa afatshkurtër	11,387	11,387
Interesi i akruar (jo i vonuar)	664	622
	12,051	12,009
Gjithsej huazimet	150,205	161,550

Kreditë e qeverisë:

Kredia e parë në vlerë prej 166,367 mijë euro është për Miniera dhe shuma kryesore dhe interesi paguhet në 18 vjet në 36 këste të barabarta, përveç pagesës së interesit të parë prej 1,500 mijë euro, e cila është paguar më 15 tetor 2015. Kryegjësja dhe interesi paguhet duke filluar nga 15 tetori 2018 dhe bart interes në normën maksimale 2.5% p.a. Kredia sigurohet ndaj pengut të impianteve dhe pajisjeve të kompanisë (shiko Shënimin 4).

Kredia e dytë në vlerë prej 25,565 mijë euro është për gjenerim dhe shuma kryesore dhe interesi janë të ripagueshme në 9 vjet në 18 këste të barabarta duke filluar nga 15 prill 2016 dhe bart interes në normën 2.5% p.a në maksimum. Kredia sigurohet ndaj pengut të pronës, impianteve dhe pajisjeve të kompanisë (shiko Shënimin 4).

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.**Shënimet për pasqyrat financiare****Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020****11 HUAZIMET (VAZHDIM)**

Plani i ripagimit të kredive është si më poshtë:

Gjithsej në EUR'000

Brenda 12 muajve	11,387
2022	11,387
2023	11,387
2024	11,387
2025	11,387
Pas vitit 2026	92,606
	149,541

11.1 Rakordimi i borxhit neto

	2020 (në EUR '000)	2019 (në EUR '000)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	67,928	67,207
Huamarrjet – të pagueshme brenda një viti	(12,051)	(12,009)
Huamarrjet – të pagueshme pas një viti	(138,154)	(149,541)
Borxhi neto	(82,277)	(94,343)
Paraja dhe investimet likuide	67,928	67,207
Borxhi bruto - normat e interesit të ndryshueshme	(150,205)	(161,550)
Borxhi neto	(82,277)	(94,343)

11.2 Ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit

	1 Janar 2020 EUR '000	Rrjedhjet e parasë EUR '000	Ndryshimet jo monetare EUR '000	31 Dhjetor 2020 EUR '000
Huazimet afatshkurtra me interes	11,387	-	-	11,387
Huazimet afatgjata me interes	149,541	(11,387)	-	138,154
	160,928	(11,387)	-	149,541

	1 Janar 2019 EUR '000	Rrjedhjet e parasë EUR '000	Ndryshimet jo monetare EUR '000	31 Dhjetor 2019 EUR '000
Huazimet afatshkurtra me interes	10,887	500	-	11,387
Huazimet afatgjata me interes	160,917	(11,376)	-	149,541
	171,804	(10,876)	-	160,928

12. GRANTET E SHTYERA

Kompania ka grante të shtyera të pranuar para vitit 2010 nga Qeveria e Republikës së Kosovës për financimin e pasurive afatgjata. Bilanci i mbetur në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	2020 (në EUR '000)	2019 (në EUR '000)
Më 1 Janar,	21,373	27,220
Të amortizuar gjatë vitit (Shënimi 17)	(5,217)	(5,847)
Gjendja më 31 Dhjetor,	16,156	21,373

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

13. PROVIZIONET

Provizionet e Kompanisë siç tregohet në pasqyrën e pozicionit financiar janë analizuar më tej si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2020 (në EUR '000)					Më 31 Dhjetor 2019 (në EUR '000)				
	Pastrimi dhe rikuperimi i tokës	Çështjet gjyqësore	Pensioni i stafit	Pagat shtesë	Gjithsej	Pastrimi dhe rikuperimi i tokës	Çështjet gjyqësore	Pensioni i stafit	Pagat jubilarë	Gjithsej
Gjendja më 1 Janar,	30,001	17,923	578	-	48,502	29,500	17,913	1,561	2,002	50,976
Shtesa gjatë vitit	1,649	2,518	139	1,463	5,769	20,001	1,683	-	-	21,684
Shuma e përdorur / e kthyer	(2,919)	(4,748)	-	-	(7,667)	(19,500)	(1,673)	(983)	(2,002)	(24,158)
Ndryshimi / lirimet gjatë vitit	(1,270)	(2,230)	139	1,463	(1,898)	501	10	(983)	(2,002)	(2,474)
Riklasifikimet gjatë vitit	-	1,957	-	-	1,957	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor,	28,731	17,650	717	1,463	48,561	30,001	17,923	578	-	48,502

Provizionet për pastrimin dhe rikuperimin e tokës:

